

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Data: 23.03		20	
Org.	Numër	Shtabja	Vlera
01	400	140	50



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Bazuar në nenin 13, 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/07, i datës 11.03.2020, me qëllim të parandalimit të infeksionit virusit COVID-19, Planit të Reagimit Kombëtar, i cili specifikon se Kryetari i Komunës ka të drejtë në rrethana të caktuara emergjente ka fuqi politike për bërjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e urdhrave dhe rregulloreve, rekomandimit të shtabit emergjent, të mbledhjes së datës 23.03.2020, Urdhresës Nr. 01/04, të datës 20.03.2020, për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik, të MEPTINIS-it, nenin 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, me qëllim të parandalimit të virusit COVID-19, merr këtë:

V E N D I M

- I. Të gjitha Marketet Ushqimore duhet ta respektojnë orarin e ri të punës dhe mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre nga ora 08:00-20:00, nga data 23.03.2020, deri në një vendim tjetër.
- II. Të gjitha këto biznese obligohen që t'i zbatojnë të gjitha masat, dhe rekomandimet e dhëna të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHP) dhe Ministrive përkatëse.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Drejtoria e Inspektionit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të komunës.

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Shtabit Emergjent;
- Marketeve Ushqimore;
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.

Kryetari i Komunës
Rajmir Lladrovci

